

## **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**, Departamenti I Përgjithshëm – divizioni penal, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Ramiz Azizi, me zyrtaren Ligjore Florentina Ademi, në lëndën penale kundër të akuzuarit Sh.R nga fsh.Ll.K.Gj për shkak të veprës penale vjedhje nga neni 252 par.1.të KPK-ës, sipas propozim akuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan Departamenti i Përgjithshëm, PP.nr. 2774/12 të datës 28.12.2012, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, më datën 12.04.2017, mori dhe në presence të palëve publikisht shpalli këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**I akuzuari Sh.R**, nga i ati R, dhe nëna N, e lindur H, i lindur me datë në fsh.Ll,K,Gj, ku edhe jeton, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, me gjendje të varfër ekonomike, Shqiptar Shtetas i R. së Kosovës.

### **Ë S H T Ë F A J T O R**

#### **S E P S E**

Me datë 28.07.2012, në kohë të pacaktuar, në shtëpinë e këtij të pandehuri, është ardhë i pandehuri Shkodran, dhe pasi e ka njoftuar Sh se telefonin celular e kishte vjedhur tek i dëmtuari D. O, dhe nuk ka guxim që të njëjtin ta mbaj, i ja jep të njëjtin, pa kundërvler pasurore, edhe pse e ka ditur se ky telefon ka qenë i siguruar me anë të kryerjes së veprës penale të vjedhjes.

- me çka ka kryer veprën penale pranimit i mallrave të vjedhura nga neni 272 paragrafi 1 të KPK-ës.

Andaj, gjykata në bazë të dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4,7,17,21,49,50,51,52, 73 dhe 80 të KPRK-ës si dhe të neneve 365 e 451 të KPRK-ës, të akuzuarit i shqipton.

## **DËNIM ME KUSHT**

*Kështu që të akuzuarit Sh. R për veprën penale pranimi i mallrave të vjedhura nga neni 272 paragrafi 1 të KPK ia cakton burgim prej 1 (nji) viti, , të cilat dënime aj nuk do ta mbajnë gjegjësisht paguajnë nëse në afatin prej 2 (dy) viteve , nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryejnë vepra tjera penale, e në të kundërtën ai do të revokohet.*

### ***I dëmtuari për realizimin e kërkeses pasurore juridike udhëzohet në kontest civil***

*Obligohet i akuzuari të paguajnë shumën prej nga 20 (njëzet) Euro , në emër të paushallit gjyqësor si dhe në emër të harxhimeve të procedurës penale në shumën e përlllogaritur në llogarinë përfundimtare të kësaj gjykate, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.*

## **A r s y e t i m**

*Prokuroria Themelore në Gjilan, e ka ngritur propozim akuzën e saj PP.nr.2774/12 të datës 28.12.2012, kundër të akuzuarit për shkak të veprës penale pranimi i mallrave të vjedhura nga neni 272 paragrafi 1 të KPK-ës.*

*Në seancën gjyqësore të datës 12.04.2017 Prokurori i Shtetit Shefik Memeti në fjalën e tij përfundimtare, pohoi se mbetet pranë aktakuzës së lartcekur, duke kërkuar që të akuzuarin Shaip Rexhepi të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit, pasi që i njejtë e pranoi fajësinë.*

*Në fillim të shqyrtimit gjyqësor pas leximit të propozim akuzës nga ana e prokurorit të shtetit si dhe deklarimit të akuzuarit e kishte kuptuar në tërësi aktakuzën si dhe veprën penale për të cilën akuzohet, duke theksuar se e pranon në tërësi dhe vullnetarisht fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale e cila sipas kësaj aktakuze i vihet në barrë.*

*Gjyqtari i vetëm gjykues, pas dëgjimit të prokurorit të shtetit dhe të të akuzuarit konstatoi se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore nga neni 248 paragrafi 1 të KPPRK-së, për pranimin e fajësisë, ngase i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza me materialet që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.*

*Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjykata e vërtetoi këtë gjendje faktike:*

*Se i akuzuari Shaip Rexhepi me dashje e ka kryer veprën penale pranimi i mallrave të vjedhura nga neni 272 paragrafi 1 të KPK-ës, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.*

*Gjykata e shpall fajtor të akuzuarin Shaip Rexhepi për shkak të kryerjes së vepres penale pranimi i mallrave të vjedhura nga neni 272 paragrafi 1 të KPK-ës, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e këtyre veprave penale dhe se për të njëjtat janë edhe përgjegjës penalisht.*

*Me rastin e matjes së dënimit ndaj të akuzuarit të lartcekur, gjykata i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, konform nenit 73 të KPRK-së, ku si rrethanë lehtësuese gjykata gjeti se i akuzuari vullnetarisht e pranoi fajësinë, se është i moshës së re, me gjendje të rëndë ekonomike, pendimin e thellë për kryerjen e veprës penale, premtimin se një gjë të tillë kurrë më nuk do ta përsërisin, sjelljen jashtëzakonisht korrekte në shqyrtimin gjyqësor, ndërsa si rrethanë rënduese dëmin e shkaktuar të dëmtuarit.*

*Sipas bindjes së lire të kësaj gjykate, caktimi i dënimit me kusht ndaj të akuzuarit Shaip Rexhepi marrë duke i pasur për bazë të gjitha rrethanat e lartcekura, është denim i të drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit si dhe me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit, nga neni 50 të KPRK-së.*

*Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale si dhe paushallin gjyqësorë është marrë në bazë të nenit 451 të KPPRK-së.*

*Duke u bazuar nga të cekurat më lartë është vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi*

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**  
**Departamenti i përgjithshëm**  
**P.nr.06/2013 Më datë 14.04.2017**

**Zyrtarja Ligjore**  
**Florentina Ademi**

**Gjyqtari i vetëm gjykues**  
**Ramiz Azizi**

**KËSHILLA JURIDIKE** : *Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.*

